

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatorë Ekonomik: LIMITPROJECT SH.P.K. me adresë në Glllogoc Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	22.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **20.09.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **LIMITPROJECT SH.P.K. me adresë në Glllogoc**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-9402-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **LIMITPROJECT SH.P.K. me adresë në Glllogoc**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-9402-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **05.09.2023**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-9402-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **LIMITPROJECT SH.P.K.** me adresë në **Glllogoc**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-9402-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **05.09.2023**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **20.09.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Certifikata ISO WD 28841-2013 (Certifikata për Vlerësimi i thjeshtuar sizmik dhe rehabilitimi i ndërtesave prej betoni); Kjo ISO WD 28841-2013 është çështje e projektimit e jo për ekzekutim të punëve dhe është e pa nevojshme në këtë fazë të projektit, andaj kërkojmë të Rishqyrtoni.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Pretendimi ankimor për Pikën 1. të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron ngase përcaktimi i kësaj kërkesë me ISO WD 28841-2023 (Certifikata për Vlerësimin e thjeshtuar sizmik dhe rehabilitimin e ndërtesave prej betoni), është kërkesë që ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit (Ndërtimin e Objektivit) në fjalë.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Sipas LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN Te Kërkesa 8: Te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës tek pika 17. Ngritëse me gërrshë vetëlëvizëse min.7, ku te kjo pajisje është e pa nevojshme, pasi që në listë të mjeteve keni kërkuar Skele dhe Piruner të cilat i kryejnë po të njëjtin shërbim, andaj kërkojmë të Rishqyrtoni sqaroni.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi ankimor për Pikën 2. të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron ngase përcaktimi i kësaj për pajisjet dhe mekanizimin, është kërkesë që ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit (Ndërtimin e Objektivit) në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmime është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmime mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit